

KOSOVO SME

Competitiveness Support Programme



PRODUKTE METALIKE KONKURRUESE

“Metal Export” Sh.P.K. u rrit nga një punishte e vogël metalesh, e drejtuar nga dy persona, në një kompani serioze me 30 punonjës në vetëm 6 vjet. Gama e aftësive në kompani përfshin operatorë makinerish, inxhinierë, specialistë ndërtimi dhe arkitektë. E vendosur në një zonë gjysmë rurale në Kosovë, kompania prodhon konstruksione metalike për industrinë e ndërtimit, profile të llamarinës, tuba metalikë, ulluqe shiu dhe dalje në rast zjarri.

I njohur si furnizues i produkteve cilësore, Metal Export i shet mallrat e veta në Kosovë por edhe eksporton në vendet fqinje dhe në BE.

Me ndihmën e Programit për Mbështetjen e Konkurrueshmërisë së NVM-ve në Kosovë, kompania bleu dhe instaloi një makineri të re me cilindra rrotulluese.

Me këtë investim, kompania rriti kapacitetin e saj prodhues për t’u shërbyer tregjeve të saj në zgjerim, shitjeve, për ta përmirësuar cilësinë e produktit përfundimtar dhe, me një rritje të vazhdueshme të fitimeve, përmirësoi edhe pozicionimin e saj konkurrent në treg. Të gjitha këto efekte pozitive kishin përmirësuar edhe aktivitetet eksportuese të kompanisë.

Pajisjet e reja funksionojnë në mënyrë më eficiente, duke konsumuar më pak energji për njësi prodhimi se e vjetra dhe, për shkak të kontrolleve të automatizuara, rezultojnë në më pak gabime dhe më pak humbje.

Karakteristikat e automatizimit të makinës së re, së bashku me trajnimin e duhur të ofruar nga furnizuesi, do të ulin ndjeshëm rrezikun e lëndimeve për punëtorët dhe do të ofrojnë mbrojtje të plotë për operatorët e makinës. Ekzaminimi i mjedisit të punës dhe instalimeve, pas instalimit të pajisjeve të reja, rezultoi në një përmirësim të përgjithshëm të shëndetit dhe sigurisë në punë për punëtorët.

Me këtë investim, kompania tani përmbush një shumëllojshmëri të gjerë të standardeve evropiane, duke përfshirë:

- Direktiva 2006/42/EC mbi makineritë dhe ndryshimin e Direktivës 95/16/EC (reformular).
- Direktiva 2014/35/BE në lidhje me vënien në dispozicion në treg të pajisjeve elektrike të projektuara për përdorim brenda kufijve të caktuar të tensionit.

Shuma e huasë	€ 250,000
Shuma e grantit	€ 37,500
Direktivat e plotësuar të BE'së	Direktiva lidhur me makineritë dhe pajisjet elektrike
Ka investuar në	Makineri e re me cilindra rrotulluese
Kursimet e energjisë dhe emitimet e CO2 të shmangura	188.01 MWh/në vit 65.13 t CO2/në vit

Konsulentët e implementimit

